

Европейская культурная столица

Културна престоница Европе

Capital Europea de la Cultura

Avrupa Kültür Başkentimiz

# Qyteti kryesor i kulturës në Europë

عاصمة الثقافة في أوروبا

Kulturna prijestonica Evrope

European Capital of Culture

Capitale européenne de la Culture

Glavni Europski Glavni Grad Kulture



LINZ 2009  
KULTURHAUPTSTADT  
EUROPAS

# Linz 2009 – Qyteti YNË kryesor i kulturës në Europë

Në vitin 1985, me iniciativë të ministres greke të kulturës, lindi idea e aksionit “Qyteti kryesor i kulturës në Europë”. Që atëherë ky titull i jepet çdo vit një ose dy qyteteve evropiane. Qëllimi i këtij aksioni është që të spikaten pasuritë dhe shumëllojshmëria si dhe ngjashmëritë e kulturave evropiane dhe të jepet një kontribut ndaj mirëkuptimit të përbashkët për qytetarët e Europës.

Në vitin 2009 Linc, sëbashku me qytetin kryesor të Lituanisë, Vilnius do të jenë qytetet kryesore të kulturës në Europë, dhe në të njëjtën kohë edhe mikëpritës. Një sfidë e tillë dhe një shans i tillë përbëjnë edhe një detyrim për një punë sa më me vëmendje dhe me më shumë kreativitet. Në këtë drejtim ne ndajmë obligim ndaj rrethanave, dëshirave dhe shpresave të qytetit dhe të rajonit Linc.

## Linc është sinonim i shumëllojshmërisë

13,2% e popullsisë së Lincit sot vjen nga ndonjë vend tjetër. Vitet e fundit Linc karakterizohet nga ndikime kulturore të ndryshme, kështu që imazhi për qytetin dhe idea për të nuk mund të imagjinohen ndryshe përveçse si një qytet i hapur për botën. Një shumëllojshmëri e tillë kulturore përbën një pasuri e një thesar të paçmuar, gjë me të cilën Linc mund të krenohet. Në vitin 2009 qyteti kryesor i kulturës dëshiron të shfrytëzojë rastin dhe ti prezantojë botës shumëllojshmërinë e tij. Ju ftojme edhe ju t'i bashkoheni qytetit kryesor të kulturës dhe nëse keni të na i shfaqni idetë tuaja (E-mail: [projekte@linz09.at](mailto:projekte@linz09.at))!

## Programi

Tashmë në vitin 2007 e 2008 do të mund të ndjehet, se si do të jetojë ky qytet në vitin 2009. Në faqen tonë web [www.linz09.at](http://www.linz09.at) mund të gjeni informacione më të gjerësishme në gjuhën gjermane dhe angleze lidhur me planifikimin e programit, lidhur me dorëzimet e projekteve, me përshkrimet e projekteve, gjithçka lidhur me lajmet e manifestacionet:

Këtë dokument informativ mund ta gjeni atje të gatshëm për ju në gjuhën: turke, serbo, kroate, boshnjake, ruse, shqipe, angleze, franceze, arabe dhe spanjolle.

# www.linz09.at

Linz 2009  
Kulturhauptstadt Europas OrganisationsGmbH  
Gruberstraße 2, A-4020 Linz

 LINZ 2009  
KULTURHAUPTSTADT  
EUROPAS